



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk.II.nr.673/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Gerlica Company” shpk, me seli ne fshatin Babush, Komuna e Ferizajit, kundër debitorit “Lunari Company”, me NUI 810186157 me seli ne Ferizaj, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.883/23 të datës 24.01.2024, me datë **05.06.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e Gerlica Company” shpk, me seli ne fshatin Babush, Komuna e Ferizajit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.883/23 të datës 24.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.883/23 të datës 24.01.2024 në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit “Lunari Company”, me NUI 810186157 me seli ne Ferizaj, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.252/2023, i datës 15.05.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Sheremet Livoreka, me seli të zyrës në Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.883/23 të datës 24.01.2024, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori kreditorit “Gerlica Company” shpk, me seli ne fshatin Babush, Komuna e Ferizajit, me datën 15.05.2023 ka paraqitur propozimin për përmbartim

në bazë në bazë të dokumentit te besueshem - Faturës me nr. 11/10/2021 dt.14.10.2021 për shumen ne lartësi prej 43,869.65 euro, ka lejuar përmbartimin e Urdhrin Përmbartimor P.nr.252/2023, i datës 15.05.2023, me të cilin është urdhëruar të gjitha bankat që operojnë në Republikën e Kosovës që ti sjellin transaksionet bankare për kreditorin ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare të gjitha bankave dhe shuma e kërkuar së bashku me shpenzimet e përmbartimit dhe shuma e përcaktuar të barten nga llogaria e debitorit, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej ditës së dorëzimit të propozimit deri në pagesën definitive, shpenzimet procedurale të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri nën kërcënimin e pasojave ligjore.

Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka, me seli të zyrës në Ferizaj duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.252/2023, i datës 15.05.2023, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbartimor Debitori, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se dokumenti mbi bazën e te cilit është lëshuar urdhri përmbartimor Fatura me nr. 11/10/2021 dt.14.10.2021 për shumen ne lartësi prej 43,869.65 euro, nuk përmban tiparet e dokumentit te besueshem. Ka kërkuar të miratohet prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbartimor të anulohet dhe refuzohet propozimi për përmbartim si dhe të obligohet kreditori që debitorit ti paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimit dhe të gjitha shpenzimet tjera, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabaza dhe ka theksuar se të njëjtat kanë për qëllim prolongimin e përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga puna juridike, e ku kredia e kreditorit bazohet ne faturat e pranuar nga pala debitorë, te cilat janë te rregullta dhe ne pajtim me ligjin.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgj, KPPP.nr.883/23 të datës 24.01.2024 ka pranuar prapësimin e debitorit, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.252/2023, i datës 15.05.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Sheremet Livoreka, me seli të zyrës në Ferizaj

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se dokumenti – faturat në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshem, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të parregullt, përkatësisht e njëjta nuk përmban tipare te përmbartueshmërisë

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet qe kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshem është i përshtatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe

gjkata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar ne ligj.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar ne Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”, konsideron se faturat e prezantuara ne këtë çështje si dokument përmbarimor ne sajë te cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, andaj në këtë mënyrë fatura nuk mund konsiderohet si dokument i besueshëm, e po ashtu nga shkresat e lendes nuk rezulton se palët kane prezantuar prova për ekzistimin e punës juridike, mbi bazën e se cilës do te derivonte fatura, si dokument i besueshëm

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk II.nr.673/24, me datë 05.06.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami